# DËSHMI ARKIVI

**A-469102**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Maran para sfidës në Ligën e Kombeve: Qëllimi ynë është të bëjmë ndeshjen më të mirë të mundshme, kemi një repart me probleme, Asllani dhe Shehu… |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/maran-para-sfides-ne-ligen-e-kombeve-qellimi-yne-eshte-te-bejme-ndeshjen-me-te-mire-te-mundshme-kemi-nje-repart-me-probleme-asllani-dhe-shehu/1027293/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 13:57:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 13:46:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `54dd385bb6bc19fc4acbc934390c95ec9b7fe6cf157a997d8578f90d2ca0ea89` |
| TEKSTI | `4466d1c02422c42868c5531427e7003bf589b90f85329d589af513139df17acc` |
| PAMJA | `37b208fe4b2a8d962da13485f711ed8dbc77a110f7f24559153834b0492bb006` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `10179b4a4d83729317b14bb3b870ac9da3d2634cc93dd61b85508dce1eaf125a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/10179b4a4d83729317b14bb3b870ac9da3d2634cc93dd61b85508dce1eaf125a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Maran para sfidës në Ligën e Kombeve: Qëllimi ynë është të bëjmë ndeshjen më të mirë të mundshme, kemi një repart me probleme, Asllani dhe Shehu…




Trajneri Rolando Maran, po flet para ndeshjes Shqipëri-Bjellorusi. Ky takim është rezervuar më 26 shtator(nesër) në Grupin 1 të Ligës C në Ligën e Kombeve.

Para raundit të parë, trajneri italian po thotë fjalën e tij në konferencë për shtyp. Për të është sfida e parë zyrtare në stolin kuqezi.

*"Bjellorusia dhe taktika ndaj tyre? Bjellorusia ka treguar se është skuadër kompakte e fortë, po bën një rrugëtim të mirë dhe kemi shumë respekt për këtë skuadër, këtij ekipi që do zbresë në fushë. Por përtej kësaj, ndalem këtu, se jam mësuar të përqendrohem te ekipi im që është përgatitur në mënyrë fantastike. Kam parë dëshirën për të punuar dhe për të gjetur stimujt e duhur përtej kundërshtarit, për mua kjo është gjëja më e rëndësishme, që të përqendroheshim te cilësitë tona.*

*Cilësinë tonë të karakterit e kam parë, kam parë sy të ndryshëm, kam parë dëshirë për të bërë, për të provuar e gabuar, por për të gabuar në aspektin që të mund të përmirësohemi. Për mua janë këto kushtet e duhura për të përballuar këtë ndeshje ndaj një skuadre që respektojmë shumë.*

*Formacioni dhe dyshimet? Po, nesër nis me të vërtetë aventura ime si trajner i Shqipërisë, është emocioni që të jep krenari, të bën të japësh më shumë, e kjo më stimulon më shumë. Idetë janë të qarta, kemi pasur ndonjë problem fizik, më është dashur të lë pushim lojtarët sidomos në një repart që kemi pasur mungesa. Por kush do të shkojë në fushë, do të shkojë për të bërë një ndeshje të mirë.*

*E vërtetë që disa nga lojtarët nuk kanë pasur mundësinë që të stërviten vazhdimisht. Nga mungesa, kemi provuar gjëra të reja dhe kam marrë disa përgjigje shumë të mira. Asllani dhe Shehu do të jenë të dy në stërvitje sot. Mbrëmjen e sotme do kem hapësira për të zgjedhur rrugën e duhur. Kanë qenë ditë impenjative, por që më kanë dhënë përgjigje shumë të mira. Dhe nëse disa lojtarë nuk do kenë mundësi të luajnë 90 minuta, kjo na jep mundësinë për të zgjedhur dhe për të zbritur në fushë një skuadër që është e gatshme për të luftuar dhe për të bërë më të mirën.*

të fundit/


Bekim Sali bojkoton takimin në New York mes Mickoskit dhe…


Maran para sfidës në Ligën e Kombeve: Qëllimi ynë është të…


Rukiqi kërkon sqarime për importin e produkteve braziliane…


Misteri i vdekjes së Geli Raubal: dokumentet e reja ngrenë dyshime…


MPJ konfirmon praninë e delegacionit të Maqedonisë së Veriut…


Katër persona kallëzohen penalisht për vjedhje të rënda…


Plagosja te "Zogu i Zi", policia zbardh ngjarjen

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

*Balliu nuk u zëvendësua? Në fakt nuk jam i shqetësuar. Kemi lojtarë të tjerë për mënyrën si dua ta interpretoj lojën. Është Sina, varet çfarë do kërkoj. Ismajli ka luajtur si mbrojtës i djathtë dhe besoj do kemi zgjedhje.*

*Lojtarët? Padyshim tani i njoh më shumë. Kam fatin që kisha, përveç grumbullimit të parë, edhe këto muaj për t'i parë direkt apo për t`i parë me video. Padyshim për mua është ndryshe tani, tani kam ide më të qartë, edhe pse i njihja më përpara, por duke u thelluar. Janë lojtarë të cilëve u kam njohur disa karakteristika që nuk i njihja në detaj. Pastaj lojtarët ndryshojnë në momente të sezonit, ka lojtarë që po vuajnë apo janë në ngritje. Unë duhet të jem i vëmendshëm, nuk është vlerësim përfundimtar por edhe i momentit me klubet e tyre apo edhe me ne. Të them emra është e vështirë, jam munduar të thërras ata që janë në gjendje të mirë, apo më të përshtatshmit. Në disa role jemi pak në vështirësi, por kjo është zgjedhja ime, edhe pas shumë pune të bërë.*

*Ndryshim skeme gjatë ndeshjes? Bjellorusia po vjen nga një periudhë e mirë, ka bërë rezultat në 6 ndeshje radhazi e do të thotë diçka. Për ne duhet të jetë stimul, përtej respektit ndaj kundërshtarit që duhet të çojmë nivelin e vendosmërisë dhe gjatë ndeshjes ka më shumë solucione dhe kam fatin që mund të zgjedh në bazë të lojtarëve e zgjidhjeve që kam në mendje. Ne kemi punuar në më shumë se një gjë për të përballuar momentet e ndeshjes. Shpesh ka ndeshje brenda ndeshjes dhe duhet të jemi të aftë t'i interpretojmë e ne jemi përgatitur për këtë.*

*Lojtarë bjellorus? Nuk më kujtohen emrat. Kam vënë re që janë persona shumë punëtorë dhe fizikisht shumë të aftë, janë gjithmonë në krye të punës.*

*Qëllimi ynë është të bëjmë ndeshjen më të mirë të mundshme dhe të mos humbasim ekuilibrin. Nuk ka rëndësi të kesh gjithmonë topin në posedim, por çfarë bëjmë në momentin që e kemi topin dhe nëse e humbasim, si e interpretojmë lojën. Ka ndeshje brenda ndeshjes. Nga ndeshjet e muajit qershor, kemi marrë disa mësime sa i përket mënyrës si kemi reaguar kur kemi humbur topin. Rezultati jo gjithmonë përcaktohet nga detaje të tilla, por fokusi është të bëjmë ndeshjen më të mirë nesër.*

*Sigurisht që gjatë një ndeshje do të ketë vështirësi, por duhet të jemi të fortë, me kurajo dhe koshientë mbi të gjitha për punën që kemi bërë. Dhe atë ta interpretojmë në fushë"*, tha trajneri.

Shtuar më 25.09.2026 15:46

Tags: Ligën e Kombeve , Maran , ndeshja , neser












Plagosja te “Zogu i Zi”, policia zbardh ngjarjen




Plagoset një person te “Zogu i Zi” në Tiranë, i lënduari dërgohet me…



Dalin pamjet e autorit në momentin e ekzekutimit të 44-vjeçarit Artan Myrtaj…



Denoncimi i qytetarit nxjerr emrin e një bashkëpunëtore tjetër të…




Sharjet nisën në TikTok, gati për sherr me shkopa bejsbolli në Yzberisht,…



Nga komandant i NATO-s te ambasador në Tiranë/ 118 ditë revoltë kundër…



Jorida Tabaku kundërshton strukturën e re të shëndetësisë: Modeli…




Vodhi 700 mijë euro të pensioneve/ Gjykata e Durrësit lë në “arrest…

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko…
Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.